



14/6 KBL.
30.10.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr. 4, datë 23/10/2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI TË
TJERA NË BRIGJE DHE SHTRATIN E BURIMIT UJOR, ME
VENDNDODHJE: LUMI ERZEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE
VAQARR, BASHKIA TIRANË, TË SUBJEKTIT “OPERATORI
SISTEMIT TRANSMETIMIT” (OST).**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës “Për autorizim për veprimtari të tjera në brigje dhe shtratin e burimit uJOR”, me vendndodhje: Lumi Erzen, Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë, të subjektit “Operatori Sistemi Transmetimit” (OST).
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit uJOR: Lumi Erzen

Koordinatat e vendndodhjes së burimit ujor (KRGJSH)

1. $X=485398.5$; $Y=4570318.8$; $Z=109.35$
2. $X=485403.6$; $Y=4570310.1$; $Z=109.12$
3. $X=485392.8$; $Y=4570302.0$; $Z=109.12$
4. $X=485384.6$; $Y=4570310.6$; $Z=109.35$

Lloji i burimit ujor ku do të kryhet veprimtaria: Lumi Erzen.

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Platformë mbështetëse e përkohëshme.

3. Të njoftohet IKMT për ndjekjen e mëtejshme të këtij vendimi si dhe ZABL të ndjekë në vijimësi respektimin e kushteve të lejes.
4. Pas përfundimit të veprimtarisë, subjekti duhet të rivendosë rrjedhën e lumit në shtratin e tij natyral.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBL ERZEN

AFRIM QENDRO

